




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Pranuar - Prilajeno Më/Dana	17.06.2020
Nr. i organit	
Org. broj	
Numeri/Idri	
Shtetësi	
Vlera	
Prilog	
Vendos	
02-035/02-473	

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 16.06.2020, bën këtë :

PROPOZIM VENDIM

Për dhënjën në shfrytëzim të Pronës Komunale NPSH „ARENA SPORT“ Në Kabash.

Neni 1

Me këtë propozim – vendim, propozohet dhënja në shfrytëzim e pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, NPSH „Arena Sport“ në Kabash e rexhistruar me numer biznesit 70396085.

Neni 2.

Prona e palujtshme e propozuar për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale e cekur në piken 1 të këtij propozimi është :

- Parcela kadastrale me nr. P -70101025-01374-2, lloji i njësisë : parcelë, zona : rurale, sipërfaqja 3857 m², vendi i quajtur: Seferin, kultura kullosë e klasit 5, pronë e P.Sh. Kuvendi i Komunës Viti, zonën kadastrale në Kabash..
- Parcela kadastrale me nr. P -70101025-01375-2, lloji i njësisë : parcelë, zona : rurale, sipërfaqja 36143 m², vendi i quajtur: Seferin, kultura kullosë e klasit 4, pronë e P.Sh. Kuvendi i Komunës Viti, zonën kadastrale në Kabash..

Neni 3.

Qellimi i dhënjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës të cekur në nenin 2 të këtij propozimi është ushtrimi i veprimtarisë për aktivitetet sportive dhe rekreacion (hotel, restora, kafiteri, fusha të sportit për futboll, voljeboll dhe basketboll, shtigje për vrapime të lira në natyrë si dhe çdo aktivitet tjetër rekreacioni dhe sportiv).

Neni 4.

Afati kohor për dhënjën e pronës së palujtshme të Komunës të cekur në piken 2 të këtij propozim vendimi është afat shkurtur në periudhën deri 15 vite.

Neni 5

Procedurat për dhënjën e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim afat shkurtër është në pajtim me neni 11 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-092, meqen se vlera e investimeve në rregullimin e arenes sportive pritët të jetë 230,000.00 € me qka tejkalohet vlera prej 10 % e bugjetit të përgjithshme për investime kapitale të komunës gjatë vitit paraprak. (Investimet kapitale komunale për vitin 2019 kanë qenë 2,123,287.00 €, kurse 10 % e kësaj vlere është 212,328.70 €).

Neni 6.

Menyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitësit marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër, me të drejt shkeputjes së kontratës edhe para afatit nese prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllimie të cekura në nenin 3 të këtij vendimi.

6.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi të komunës së Vitisë.

7.

Neni .

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.



Arsyetim

Kuvendi Komunal i Vitisë me Kontratë Koncesioni 01-016/1679, të datës 13.04.2007, NPSH "ARENA-SPORT" ia ka dhënë në shfrytëzim sipërfaqen e përgjithshme prej 40000m² për periudhen 10 vjeqare pjesët e parcelës kadastrale 1374 dhe pjesën të parcelës kadastrale 1375 në vendin e quajtur :Seferin, në zonën kadastrale në Kabash. Sipas kësaj Kontrate të Koncesionit ka qenë që NPSH "ARENA-SPORT" të zhvilloj aktivitete në vijim : restoran, fushë për futboll të vogël, fushën e basketbollit, fushën e voljebollit, shtigje për vrapim , shtigje për vrapim të gjatë (Olimpik) dhe qfardo aktiviteti tjetër rekreacion dhe sportive.


Për zhvillimi e suksesshem të këtyre aktiviteteve rekreacioni dhe sportive NSHP "ARENA-SPORT" ka paraqitur Plan Biznesin Strategjik NRB:70396085, për këtë periudhë që do ti jepet në shfrytëzim. Kërkesa e NPSH "ARENA-SPORT" për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale për periudhen bazohet në vlerën e investimeve të tanishme si dhe investime e planifikuara në të ardhmen, gjithashtu kjo kërkesë bazohet në nenin 11 të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, pa zhvilluar procedura paraprake duke i ofruar oferten komunës për investimet e vlerës së paku 10% të bugjetit të përgjithshmem për investime kapitale të Komunës nga viti paraprak; gjithashtu për këtë pronë nuk ka pasur interesim për marrjen në shfrytëzim nga pala e tret së paku 3 vitet e fundit.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në këtë propozim.

Drejtori:
Majlinda Ostrogllava




Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti



N.P.SH. "ARENA-SPORT"

NRB:70396085

PLAN - BIZNESI STRATEGJIK 2020-2040



Punuar nga Pronari : **Adem ZEQIRI**

Viti:

Datë: Mars/2020

Parathënja

1. Përmbledhja ekzekutive
2. Përshkrim i shkurtër i biznesit , produktet ose shërbimet, përmbushja e nevojave të klienteve
3. Deklarimi i Misionit dhe Vizionit të Biznesit
4. Profili i biznesit dhe industrisë
5. Lokacioni dhe asetet ekzistuese-investimi
6. SWOT Analiza
7. Shërbimet dhe produktet
8. Plani i Marketingut
9. Analiza e tregut
10. Strategjia e Marketingut...
11. Plani i Shitjes
12. Analiza e konkurrentëve në tregun e synuar
13. Struktura organizative-Organizimi i biznesit
14. Plani Financiar

Hyrja

1. Përmbledhja ekzekutive

Kompania N.P.SH. “Arena - Sport” me seli në Kabash- Viti me NUI 810678708 (ish NRB 70396085) duke u bazuar në ligjin mbi Shoqëritë Tregtare 03/L-023, përkatësisht bazuar në nenin 33 të këtij ligji.

Veprimtarin e vet e ka filluar qe nga viti 2006 me nje kapacitet te limituar ne lemin e sherbimeve perkatësisht veprimtarit kryesore te saja janë, Pushimet dhe akomodimet e tjera me qëndrim të shkurtër, Aktivitetet shërbyese të pijeve, Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit, Akomodime të tjera dhe aktivitetet sekondare Kampingjet, parqet me mjete rekreative dhe me rimorkio.

Fillimisht vlere qarkulluese ishin te vogla duke u bazuar ne ate se ishte biznes i cili ishte krijuar ne nje teren qe ishte jo atraktiv dhe mungonte thuaj se gjithqka, rruga ishte e pa rregulluar, ishte teren qe e njihnin rrethi dhe opinjoni si teren i deponive te mbeturinave, si nje teren qe kishte nje largesi te theksuar nga qendra e Vitisë, kete pra e bente edhe rruga qe ishte e pa asfaltuar. Shtrirja e tregut-klienteles ishte me permasa jashtezakonisht te kufizuara ,pra eshte dashte investim i theksuar në ngritjen e atraktivitetit te kesaj qendre si ne aspektin financiar ashtu edhe ne imazhin e teresioshem te biznesit dhe terenit - ambientit, tani kemi nje shtrirje edhe jashte kufinjve te komunës, kufinjëve lokal, falë angazhimit të pronarit- drejtorit Adem Zeqiri. Ne pretendojmë të kemi dominim në tregun lokal dhe më gjërë edhe Kosovare ne aspektin kualitativ ashtu edhe ne ate kuantitativ duke u bazuar ne angazhimin e gjertanishem te pronarit. Pronari kompanise si nje afarist i sukseshem ne sferen e bizensit ka investuar ne kete zone ne asfaltimin e rruges qe qon deri tek selia e biznesit, investimet ne energji elektrike, investimet ne lokalet perkatesisht objektin e biznesit, imvestimet ne marketing, investimet ne shtimein e atraktivitetit te zones duke e shendrruar nga nje zone e ndotur dhe e lene pas dore ne nje zone atraktive dhe shendrrimin ne nje zone rekreative.

Detyrat kryesore te biznesit tone janë aktivitet shërbyese, ndërmarrja është e menaxhuar nga drejtori i saj, Adem Zeqiri me një përvojë mbi dhjetë vjeqare në lëmit e këtilla. Përshkrimi I detyrave te punës si dhe përgjegjësit e organit udhëheqës janë te definuar me Rregulloret e brendshme te biznesit.

Ne tani me qellim te zgjerimit te veprimtarisë tone jemi duke punuar me te madhe ne drejtim te fillimit te një investimi te madhe ne lëmin e investimeve ne terenet sportive, renovimin e ambienteve te biznesit, imazhin e teresishem te biznesit, ku parashohim qe ka nevojë qe biznesi te mbahet funksional dhe te vazhdohet kontinuiteti ne drejtim te dhenjes se sherbimeve kualitative dhe sigurim te përfitimeve per biznesin.. Plan biznesi përshkruan rrugëtimin e biznesit për te arritur një zhvillim te qëndrueshëm dhe efikas përmes krijimit te shërbimeve – produkteve cilësore, sipas standardeve evropiane . Për te arritur këto qëllime biznesi ynë ka parapare një strategji 20 vjeçare duke u mbështetur në premisa të sigurta për te avancuar drejt suksesit. Aktualisht lëmia për te cilin jemi duke u angazhuar është një lëmi specifike ku kërkohen investime te mëdha, efikasitet dhe efektivitetet e shumta.

Situata aktuale e biznesit dhe qëllimet, aktualisht kemi nje qarkullim solid dhe te qendrueshem dhe kemi nje treg shumë te mire.

Synimi I biznesit është që të arrijmë një biznes stabil të qëndrueshëm dhe dominues në aktivitetet për të cilat jemi edhe të specializuar konform standardeve profesionale. Kemi kryer investim të madh financiar dikund në vlera përafërt prej gjashtëqind mijë eurosh dhe tani në periudhën prej katër vitesh presim të investojmë mbi **230,000.00€** investime të specifikuara konform projektit, gjithashtu me qëllim të vazhdimin të kontinuitetit të biznesit presim që pas periudhës katër vjeqare të investimit të kemi investime dhe riparime tjera në biznes, këto e kemi përshkruar në pjesën financiare të biznesit.

Qëllimi ynë është që të arrijmë të bëhemi lider në sferën perkatese të shërbimeve përmes arritjes së financimit të investimeve të parapara, e që arrijnë një shumë prej 230,000.00 euro, qëllimi ynë është gjetja e burimeve të financimit dhe atë burimeve të kombinuara ku pjesa e fillimit të investimit është kursimi i ynë që kemi bërë deri më tani dhe pjesa tjetër do të jetë pjesa e të hyrave që do të gjenerohen nga biznesi, pa rrezikuar në kredi apo financime bankare, edhe pse jemi të sigurt se kjo do të realizohet pa u futur në fyte të ngushta, prapë se prapë në kemi zhvilluar edhe negociatat me bankat të cilat operojnë dhe kemi marrë premtime se nëse hasim në vështësi në do të kemi mbështetjen financiare me kamata të volitëshme..

Vlerësimet e bëra nga biznesi rezultojnë që financimi-investimi është i qëndrueshëm dhe rezulton me rritje të performancës financiare të biznesit llogaritjet NPV dhe IRR japin një qëndrueshmeri dhe kthime të mjeteve për një periudhë relativisht të shkurtër.

Ndërmarrja e jonë do të jetë e përkushtuar në aktivitetet primare - sekondare të shërbimeve, i ka identifikuar të gjitha përparësitë dhe mangësitë për të avancuar drejt një ndërmarrjeje të qëndrueshme dhe tejet atraktive me shërbime të kualitetit të lartë në një ambient ekologjik dhe atraktiv.

2, Përshkrim i shkurtër i biznesit , produktet ose shërbimet, përmbushja e nevojave të klienteve

Kompania N.P.SH. "Arena-Sport" veprimtarinë e vet e ka filluar që nga viti 2006, fillimisht me kapacitete të kufizuara dhe me aktivitete – shërbime të kufizuara, kryesisht në tregun – klientel lokale, vizitor të paket. Duke filluar nga vitet kur biznesi edhe perfundoi investimet në infrastrukturen rrugore, elektrifikim dhe investimet në marketingun e biznesit, ndryshimet ishin tejet të mëdha, u bë ndryshimi i imazhit të biznesit (emri i mirë). Duke u bazuar në rritjet dhe kërkesën e klienteve , kompania është orjentuar në rritjen e kualiteteve investime në terene sportive për tregjet – klient edhe jashtë kufinjve

lokal duke i shtuar vleren dhe atraktivitetin zones se fshatit Kabash dhe komunes se Vitisë dhe njekohesisht edhe biznesit si nje indikator pozitiv

3, Deklarimi i Misionit dhe Vizionit te Biznesit

Misioni I biznesit është dhenja e shërbimeve me kualitete te larta qe I përgjigjet kerkesave te klienteve dhe zgjerimi I tregjeve – klienteles duke përfshirë edhe klientë ndërkombëtar e- bazuar ne atraktivitetin e terenit dhe shërbimeve kualitative.

Vizioni I biznesit eshte qe permes produkteve-shërbimeve kualitative te arrijme rolin e liderit ne fushen e aktiviteve te tilla biznesore sidomos në fushen e shërbimeve te reja rekreative-sportive per tregjet-klient e mbrenshme dhe te Jashtme (klientet).

4, Profili i biznesit- industrisë

Veprimtaria e bisnesit bene pjese ne aktivetet e sheerbimeve hoteliere –turizëm, rekreacion, industrin e ushqimit, me kualitet-atraktivitet qe lene per tu deshiruar.

- a) Qëllimet tona janë kryesisht ne rritjen e trugut-klienteles së brenshem dhe te jashtem (klienteles) permes se ciles do te arrihen rritja e imazhit- atraksionit te rajonit, nga kjo rrjedh edhe mundesia e rritjes se vlereave qarkulluese monetare. Nga kjo presim nje rritje prej 20% qe nga viti 2020 dhe nje rritje mesatrisht prej 50%-80% deri ne vitin 2040.
- b) Qellimet operative; gjendja aktuale e biznesit eshte funksionale dhe me perfitime te cilat mundesojne mbijetese, perfitime dhe ka performanca pozitive, por e njejta nuk permbush kapacitete integruese ne procesin, ate qe deshirojme ne te ardhmen. Arsyeja kryesore eshte investimi ne projektet e caktuara te cilat i kemi parapare, ne te njejten kohe kemi avansuar edhe sistemin e kontrollit-mbikqyrjes.
- c) Objektivat tona kryesore jane rritja e kualitetit te shërbimeve dhe zgjerim te tyre, kursimi kohes ose rritjes se sasise se shërbimeve (efikasitet, ekonomizim dhe efektivitet).
- Ne parashikojme qe me futjen ne funksion te programit investiv 2020-2040, ekziston mundesia te bejme edhe riorganizimin dhe risistemin ne qeshtjet operative te shërbimeve sepse kete na mundeson edhe tereni-ambienti i ri - performanca operative te integruara sa I perket perdorimit te fuqise puntore ne proces te kryerjes se shërbimeve. Tani kemi 3 puntore aktiv gjate sezonit levizin deri ne 5,7 punetor .
- Objektivat financiare I parashohim si lehte te realizuaeshme nese realizohen performancat operative , ne kemi lehtesime te medha ne kete drejtim sepse e kemi tregun-klientelen, kemi klientelen shume te suksesshme dhe mbetetet vetem te finalizojme pjesen operative dhe te startojme furishem ne sferen financiare. Ajo qka eshte me rendesi bazen finaciare per momentin

e kemi por parashohim qe diferencat te mbulohen permes financimeve nga kursimi dhe funksionimi i vijimësisë se biznesit si rezultat i performances se sukseshme nga bankat apo institucionet tjera varesisht nga benifitet qe ofron institucioni I financimit. Kemi nje stabilitet te qendrueshem financiar nga aspekti vetanak sepse kemi nje monopol si ne furnizimin ne lenden e pare ashtu edhe tek ofrimi I produkteve, mirëpo nuk deshirojme qe te shkaktojme fyte te ngushta te prodhimit andaj nje pjese e orjentojme ne financime eksterne.

5, Lokacioni dhe asetet ekzistuese-investimi

Ndërmarrja ka selinë në Fsh. Kabash , pra ne kilometrin e tretë te qytetit të Vitisë

Asetet ekzistuese te biznesit janë Zyra e biznesit e pajisur me inventarë dhe teknologji informative, automjetet e biznesit lokacioni-ndertesa (restauranti) se bashku me asetet brenda restaurantit , investimi ne rruge deri tek restauranti , instalimi i energjise elektrike, etj, te gjitha keto kapin nje vlere investuese te deritanishme me nje shume prej mbi 600.000 €.

Ne kemi planifikuar nje investim prej 230,000.00€ pesë (5) vjeqare, viti i peste konsiderohet viti permbleddhes ne rrumbullaksim te investimit dhe ate sipas viteve , viti pare prej 57,000.00€, viti i dytë 55,000.00€, viti i tretë 61,000.00€, viti i katert prej 57,000.00€, viti i pestë konsiderohet perfundim i projektit,

Perveq ketij investimi kemi edhe investime te tjera te mirembajtjes-kontinutetit te investimeve dhe aseve ekzistuese ku kemi per qdo vit shuma te alokuara ne drejtim te ruajtjes se funksionalitetit te biznesit deri ne 30 mijë euro vjetore deri ne vitin 2040.

6. SWOT Analiza

- a) Perpresit e biznesit tone jane sepse ne jemi veq duke funksionuar, kemi sherbime te kualitetit te larte, ambient atraktiv ne periferi te qytetit dhe me nje ambient dhe ajër te paster, fusha sportive, kende lojërash e mbi te gjitha me një kuzhine dhe shërbim superior, kemi nje staf te pergadituar ne te gjitha sferat, mbi te gjitha kemi nje klientel shume te mire.
- b) Mangësitë jane te pakta mirepo ajo qe po na pengon eshte mungesa e dhenjes se lejes se shfrytezimit te prones nga ana e Komunes e cila po na e pamundeson investimin sepse kemi nevoj qe te intervenojme me investime edhe pse ambienti eshte funksional mirepo ka problem dhe ngecje ne aspektin e avansimit ne te ardhmen, kjo na bene te mos ndihemi te sigurt ne aktualitetin dhe te berit biznes ne sfera afatgjate.
- c) Mundesit jane te pa krahasueshme nese arrijme te marrim aprovimin nga Komuna ne lidhje me shfrytezimin e prones ,financojme investimin I cili eshte prioritet I biznesit, kemi stafin e kualifikuar, tregun - klientelen shume funksionale dhe efikase, gjithashtu edhe monopolin ne sferen atraktivitetit te terenit, fushave sportive, kampingjeve, etj.

- d) Kërcënimet janë të paketa, ato munde të konsiderohen ndërprerja e aktivitetit biznesor si rezultat i mos dhënies së lejes, futja e konkurrenteve të rinj, ofrimi i çmimeve me të lira nga konkurrenca, përkeqësimi i situatës ekonomike në vendit, kamatat e larta të kredive nëpër bankat që operojnë në Kosovë.

7. Shërbimet dhe produktet

Strategjia jonë e përpiluar për një periudhë prej 20 (5+5+5+5) vitesh ka radhitur si shërbime primare, shërbimet-pushimet, akomodimet me qëndrim të shkurtër, shërbime të ushqimit dhe pijeve, kampingje, parqe, etj duke llogaritur të gjitha sfidat e mundshme në rrugëtimin tonë drejt realizimit të një shërbimi me kualitativ dhe standard sipas kriterëve ligjorë dhe standardeve në fuqi.

Shërbimet e ofruara dhe të lartecaktuara do të jenë shërbime kryesore me të cilat edhe do të identifikohet biznesi, kosto e investimit do të jetë e lartë mirëpo përfitimet nga ky investim do të arrijnë gjenerim dhe kthim të shpejtë të investimit.

Përmes këtij projekti në synojmë të arrijmë qëllimet tona financiare dhe operative.

8. Plani i Marketingut

Në mënyrë që të arrijmë objektivat e lartcaktuara për vitin 2020-2040 ne kemi kombinuar disa strategji në mënyrë që rezultati të jetë më i mirë dhe më lehtë i matshëm.

Në mënyrë që të arrijmë rritjet e parapara ekonomike qoftë në shërbimet edhe në aktivitetet sekondare, kemi zgjedhur strategjitë e marketingut adekuate për llojin e shërbimeve dhe nevojat e ndryshme që kanë këto shërbime. Në shërbimet tona ne do t'i përdorim tri metoda strategjike dhe atë:

- Metoda zgjeruese, ku do të orientohejmë drejt klientëve të rregullt;
 - Metoda depërtuese/zgjeruese, në drejtim të klientëve potencialë si dhe
 - Metoda të avancuar, në drejtim të klientëve të ri.
- Në ofrimin e shërbimeve të klientëve të rregullt, ne do t'i përdorim metodën zgjeruese ku do të orientohejmë drejt klientëve të rregullt, metodën depërtuese në drejtim të klientëve potencialë. Në shërbimin e shërbimeve- të konsideruara si të reja për klientin të ri ne do ta përdorim metodën depërtuese e cila do të orientohej në zbrazëtitrat e identifikuar që kemi në treg tek klientet.
- Ndërsa sa i përket realizimit të objektivave tjera që janë cekur më lart qasja jonë do jetë e fokusuar në:
- Kontrollin e kualitetit të shërbimeve në baze të standardeve adekuate;
 - Shkollimin dhe trajnimet e stafit karshi zhvillimit të fushave përkatëse dhe
 - Punësime të reja
 - Ndërsa në mënyrë që të përmirësojmë dhe zhvillojmë imazhin e kompanisë sonë, ne kemi planifikuar që edhe gjatë vitit 2020 të mbajmë një rol aktiv në sponsorimin e aktiviteteve të ndryshme në nivel vendi.

9. Analiza e tregut

Madhësia aktuale e tregut-klienteve tanë, në vitin 2020, në zonën ne te cilen operojmë-shërbimit është jashtëzakonisht e kënaqshme, mirëpo kjo na shërben edhe si një orientim i mire drejt strategjis për vitet në vijim, për shkak të ekzistimit, kemi një monopoli në fushën perkatese në zonën ku operojmë, kete e bënë atraktiviteti i terrenit, kuzhina e mire me kuzhinjere të njohur dhe profesionist, terrenet sportive të cilat do të jenë një e ardhme e suksesshme e biznesit, perkushtimin ndaj klientit, ne kemi parapa që krahas investimit të bërë të mbajmë edhe kontinuitetin e biznesit përmes investimeve në asetet aktuale, pastaj orientohejmë edhe në zgjerim të biznesit . Ne kemi identifikuar klientit potencial dhe presim që ne të ardhmen të hyjmë përpilimit të projektit dhe ekzekutimit të tij.

Ne tregun e tanishëm ekzistojnë biznese të kësaj fushe mirepo me aktivitete të tilla jo! Sepse ne kemi paraparë

edhe ndërtim të tereneve sportive, shetitore të ndryshme , parqe lojrash për fëmijë, etj.

10. Strategjia e Marketingut...

Ne kemi parapa shfrytëzimin e mjeteve të ndryshme të komunikimit i shfrytëzuar dhe vazhdojmë të shfrytëzojmë mjete të ndryshme komunikimi (TV, billboard, fletushka)për sensibilizimin e këtij plani zgjerimi dhe përmirësuar vetëdijesimin e klientëve tonë. Plan i Biznesit 2020-2040, ka parapare që të vazhdojë të ruaj pozitën e të punësuarit një menaxher për Klientët, për të përmirësuar relacionin me klientët, për mbajtje të performances . Këtë vit do të kemi aktivitete të ndërlidhura më tepër me promovimin e aktiviteteve që nënvizojnë rëndësinë e aktivitetit shërbyes katalogut tonë të shërbimeve. Gjithherë duke planifikuar të bëjmë një studim mbi kënaqshmërinë e klientëve tanë karshi shërbimeve. Për këtë planifikojmë angazhimin e ndonjë Organizate joqeveritare, apo instituti të specializuar të kësaj fushe. Disa nga pyetjet që do të i parashtrijmë e që do të shprehën në përqindje do të jenë; Sa klientë janë plotësisht të kënaqur me përpikshmërinë dhe kualitetin e shërbimit të ofruar, kjo do të vlejë në fazat e tjera, perseritje , me qëllim mbajtjes të kontinuitetit. Sa klientë, shprehur në përqindje, janë plotësisht të kënaqur me kohën e shërbimit; Sa klientë shprehur në përqindje janë plotësisht të kënaqur me punëtorët e ndërmarrjes; Sa klientë shprehur në përqindje janë të kënaqur me informimin me kohë rreth ndryshimeve në biznes qofte edhe qmimeve për shkak të ndryshimeve të bërë; .Ne do të punojmë në drejtim edhe të përcaktimit të çmimit të volitshëm për klientin, bazuar edhe në mundësit apo kosto plus fitimi solid drejt arritjes së objektivave të tona.

11. Plani I Shitjes

Qëllimet kryesore të kompanisë janë:

- Të ofroj shërbimin me kualitete të larta ;

- Të bëjë investimet e nevojshme, qoftë nga të hyrat vetanake apo nga ndonjë donatorë I, gjegjësisht nga kredit favorizuese me norma te interesit te ulëta;
- Të zvogëloj shpenzimet operative;
- Këto hapa do të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes momentale pas periudhës se peste (vitit):
 - Ristrukturimi i vazhdueshëm i organizimit të punëve dhe punëtorëve në ndërmarrje, për të rritur efikasitetin e ndërmarrjes.
 - Planet efikase të operimit të stafit bazuar në metodat bashkëkohore të punës si në operativë , ashtu edhe në financa dhe administratë.
 - Bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe shoqatat qeveritare dhe joqeveritare
 - Rritja e përpjekjeve të marketingut për ngritjen e vetëdijes mbi ambientin dhe rolin e Kompanisë
 - Në këtë aspekt, përgatitja e fletushkave dhe spoteve televizive mbi funksionimin, ofertat tona dhe atraktivitetin e terrenit, etj.


12. Analiza e konkurrentëve në tregun e synuar

Në mënyrë që të kemi një përcjellje në kohë të duhur për veprim të rezultateve të këtij plani ne do të përdorim disa mekanizma matës për secilin objektiv kryesisht në këto pika:

- Monitorimi i realizimit të të hyrave dhe krijimit të shpenzimeve;
- Monitorimi i rritjes/rënies së kërkesave është fjala ne zgjerim te shërbimeve ;
- Monitorimi i rritjes /rënies së ofertave (organizimeve te ndryshme)-atraktiviteti i biznesit;
- Monitorimi rreth krijimit të klienteles se re-marketingut;
- Monitorimi i përfitimit të klientëve të rinj;
- Monitorimi i mbajtjes së klientit-klientëve ekzistues dhe potencialë;
- Monitorimi i kënaqshmërisë së klientit-klientëve tanë me shërbimet –produkte,
- Monitorimi i pozicionit tonë ndaj konkurrentëve tanë edhe pse deri me tani nuk ka konkurent qe do te na bente konkurenc te atill qe do te na imponoj nje premise apo diktim trgu, ne rrethinen ku eshte ne funksion biznesi;
- Monitorimi i sistemit të komunikimit përmes kontakteve dhe takimeve të përbashkëta me klientët dhe shfrytëzuesit te shërbimeve efikase dhe efektive rreth ofertave te ndryshme per organizime ;
- Monitorimi i realizimit të projekteve kapitale sipas kohës dhe buxhetit të paraparë dhe Monitorimi i te hyrave te realizuara.

13. Struktura organizative-Organizimi i biznesit

Biznesi ka të ndërtuar strukturën organizative – organogramin e kompanisë, përshkrimin e vendeve të punës konform rregullave të brendshme dhe parashikimeve të veta, rregullativave ligjore në fuqi.



14. Pasqyrat Finaciare analizat biznesore

Ne kemi bere nje plan starategjik për një periudhe pesë vjeqare me një përkushtim të veqant rreth te hyrave të parashikuara dhe arkëtimve duke u përqendruar në investimin e planifikuar dhe kerkesat e orjentuara drejtë vetëfinancimit. Pasqyrat financiare perfshinë periudhëen 2020-2040.



Analiza financiare - Të dhënat e pasqyrës së të ardhurave

Emri i Kompanisë:

N.P.Sh. "Arena-Sport"

	Vitet	Vitet	Vitet	Vitet	Vitet
	2020	2021	2022	2023	2024
<i>Te ardhurat nga shitja primare-Kuzhina</i>	43,200.00	57,024.00	68,428.80	82,114.56	98,537.47
<i>Te ardhurat nga shitjet -Banaku</i>	28,800.00	31,680.00	33,897.60	36,270.43	38,809.36
<i>Te ardhurat -Rezervimet</i>	33,250.00	34,912.50	36,658.13	38,491.03	40,415.58
<i>Deponime -Kursimet nga vitet e meparshme</i>	12,000.00				
<i>Te ardhurat totale-Shitjet</i>	117,250.00	123,616.50	138,984.53	156,876.02	177,762.42
<i>Kostoja e mallrave te shitjes</i>	48,072.50	51,918.93	58,373.50	65,887.93	74,660.22
<i>Te ardhurat operative</i>	69,177.50	71,697.57	80,611.02	90,988.09	103,102.20
<i>Shpenzimet e shitjes</i>	691.78	716.98	806.11	909.88	1,031.02

Shpenzimet e pergjithshme & Administrative	5,534.20	5,735.81	6,448.88	7,279.05	8,248.18
Fitimi para interesit, taksat, amortizimi (EBIDTA)	62,951.53	65,244.79	73,356.03	82,799.17	93,823.00
Amortizimi -Korrigjimi i vleres se aseteve	7,500.00	7,500.00	7,500.00	7,500.00	7,500.00
Fitimi para interesit & Tatimit (EBIT)	55,451.53	57,744.79	65,856.03	75,299.17	86,323.00
Shpenzimet e interesit					
Shpenzimet tjera (te ardhurat)					
Te ardhurat neto para tatimeve (NIBT)	55,451.53	57,744.79	65,856.03	75,299.17	86,323.00
Shpenzimet e tatimit ne te ardhura	4,345.15	5,774.48	6,585.60	7,529.92	8,632.30
Te ardhurat neto pas tatimeve (NIAT)	51,106	51,970	59,270	67,769	77,691



Analiza financiare - të dhënat e bilancit

Vitet	Vitet	Vitet	Vitet	Vitet
2020	2021	2022	2023	2024

Assets

Ekuivalentët e Parasë dhe Parave të gatshme	5,500.00	6,050.00	6,655.00	7,320.50	8,052.55
Llogaritë e arkëtueshme	4,320.00	5,702.40	6,842.88	8,211.46	9,853.75
Inventori	2,500	2,750	3,025	3,328	3,594
Shpenzimet dhe depozitat e parapaguara	150	165	182	200	220
Pasuritë e tanishme qarkulluese					
Asetet totale qarkulluese	12,470	14,667	16,704	19,059	21,720
Tokë dhe Ndërtesa	540,000	540,000	540,000	540,000	540,000
Furniture and Equipment	15,000	15,000	15,000.00	15,000	15,000
